



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 4568/prot.

Tiranë, më 22/6/2026

VENDIM

Nr. 250, Datë 22, 6, 2026

Bazuar në pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 845, datë 03.07.2025, "Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional", në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, paraqiten të dhënat si më poshtë:

1. **Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz.
2. **NIPT :** L51327451R.
3. **Organizimi i institucionit:** Shkollë e mesme profesionale publike.
4. **Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë e mesme profesionale

Pasi mora në shqyrtim raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit, të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

Konstatoj se:

- a) procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara për këtë proces;
- b) vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c) raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

Akreditimin e Ofruesit Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, për kualifikimet profesionale II -IV të KSHK-së si më poshtë vijon:

1. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Niveli II i KSHK-së, T-II-25.
2. Multimedia, Niveli IV i KSHK-së, T5-IV-21.
3. Rrjete të dhënash, Niveli IV i KSHK-së, T1-IV-21.
4. Zhvillim website, Niveli IV i KSHK-së, T3-IV-21.

5. Shërbime mjetesesh transporti, Niveli II i KSHK-së, M-II-25.
6. Shërbime elektro-auto, Niveli III i KSHK-së, M3-III-22.
7. Shërbime motorri, Niveli III i KSHK-së, M1-III-22.
8. Shërbime elektro-auto (Arsim i dyfishtë), Niveli III i KSHK-së, M3-III-22.
9. Shërbime mjetesesh transporti, Niveli IV i KSHK-së, M-IV-23.
10. Hoteleri-Turizëm, Niveli II i KSHK-së, G-II-22.
11. Kuzhinë (Arsim i dyfishtë), Niveli III i KSHK-së, G8-III-24.
12. Kuzhinë - Pasticëri, Niveli III i KSHK-së, G2-III-22.
13. Shërbime në hotel dhe restorant, Niveli III i KSHK-së, G5-III-24.
14. Hoteleri-Turizëm, Niveli IV i KSHK-së, G-IV-25.
15. Bujqësi, Niveli II i KSHK-së, H-II-22.
16. Agroturizëm, Niveli IV i KSHK-së, H8-IV-25.
17. Bujqësi, Niveli IV i KSHK-së, H-IV-25.
18. Agrobiznes, Niveli IV i KSHK-së, H/I-IV-22.
19. Elektroteknikë, Niveli II i KSHK-së, E-II-21.
20. Instalime dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe tensionit të lartë, Niveli III i KSHK-së, E2-III-21.
21. Elektroteknikë, Niveli IV i KSHK-së, E-IV-25.
22. Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, Niveli II i KSHK-së, O-II-22.
23. Shërbime kujdesi për fëmijë, Niveli III i KSHK-së, O2-III-24.
24. Shërbime kujdesi për të moshuar, Niveli III i KSHK-së, O1-III-24.
25. Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, Niveli IV i KSHK-së, O-IV-25.
26. Shërbime kujdesi për të moshuar (Pilot) Niveli IV i KSHK-së, O1-III-24.
27. Rrjete të dhënash (Pilot), Niveli IV i KSHK-së, T1-IV-21.
28. Menaxhim i strukturave akomoduese, Niveli V i KSHK-së G1-V-24.
29. Teknologji automatizimi, Niveli IV i KSHK-së E5-IV-24.

Afati i akreditimit fillon me datën e daljes së këtij vendimi dhe ka vlefshmëri 4 vjet.

Ofruesi i AFP-së duhet të plotësojë rekomandimet e raportit përfundimtar të akreditimit referuar shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi, në përputhje me propozimin përkatës nr. 85/6, datë 28.05.2026, ardhur nga AKAFPK-ja.

Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kuadrit ligjor në fuqi, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe për monitorimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të akreditimit, sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj

